



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 246, datë 04.11.2019

PËR

**MIRATIMIN E PJEËMARRJES SË GJYQTARËVE NË TRAJNIMIN VAZHDUES
PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR PERIUdhËN
TETOR – DHJETOR 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68, 88 shkronja “a” dhe “c”, 272 pika 3 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenit 5 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale bazuar në kërkesën e materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi bashkëlidhur këtij vendimi e pjesë përbërëse e tij.
2. Gjyqtarët e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
3. Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditën që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues.
4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët sipas listës së miratuar bashkëlidhur këtij vendimi, ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR